

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MJETE TRANSPORTI”

LOTI 1: “BLERJE MINI MJET NGARKUES ME RROTA PËR MAGAZINË”

LOTI 2: “BLERJE MOTOÇIKLETA”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): KODI
CPV: 34100000-8 Automjete; 34410000-4 Motoçikleta.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 375 000 *(gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e pese mijë)*
Lekë pa Tvsh.

LOTI 1: 5 000 000 *(pesë milion)* **Lekë pa Tvsh.**

LOTI 2: 1 371 996 *(një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë)* **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1: “BLERJE MINI MJET NGARKUES ME RROTA PËR MAGAZINË”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, si dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, Sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë afatit të vlefshmërisë së saj, si dhe për të mbrojtur autoritetin kontraktor nga tërheqja e pajustificuar e ofertës, mosparaqitja e dokumentacionit provues ose refuzimi i nënshkrimit të kontratës nga ofertuesi fitues. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit kërkohet si mjet paraprak për verifikimin e përmbushjes së kushteve të kualifikimit, në funksion të zhvillimit të një procedure efikase, të shpejtë dhe të kontrollueshme. Këto kërkesa vlerësohen të nevojshme për garantimin e rregullshmërisë së procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata e kërkuar. *(Çertifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

2.1.2 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikata e kërkuar është e detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, si dhe në nenin 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*. Kërkimi i certifikatës SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente synon të provojë se operatori ekonomik ushtron veprimtarinë nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton standardizimin e proceseve, kontrollin e furnizimit dhe qëndrueshmërinë e cilësisë së produkteve. Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të sigurohet që furnizimi të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat cilësore të përcaktuara. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën e kontratës dhe shërben për të verifikuar aftësinë organizative të operatorit ekonomik për ekzekutimin e rregullt të saj.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin zyrtar që vërteton të jetë i pajisur me licensë me kodin VII.3.B.1 për blerje, shitje, e mjeteve me motorr dhe rimorkio sipas legjistacionit në fuqi, të lëshuar nga organet kompetente shtetërore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *(i ndryshuar)*; Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” *(i ndryshuar)*, Udhëzimi Nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e

veprimtarisë në transportin rrugor". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" (*i ndryshuar*) dhe në nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (*i ndryshuar*). Paraqitja e pasqyrave financiare vjetore për 3 vitet e fundit kërkohet për t'i mundësuar autoritetit kontraktor verifikimin e gjendjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit ekonomik, në funksion të aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohet të vlerësohet nëse operatori ekonomik ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me mallrat objekt prokurimi. Kushti që në dy balance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të verifikuar një nivel minimal qëndrueshmërie financiare dhe për të shmangur rrezikun e mosrealizimit të kontratës për shkaqe që lidhen me paaftësinë ekonomike të operatorit. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" (*i ndryshuar*) dhe në nenin 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (*i ndryshuar*). Kërkimi i një xhiroje vjetore jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit synon të verifikojë se operatori ekonomik ka kapacitet financiar dhe aktivitet tregtar të mjaftueshëm për të përballuar realizimin e kontratës. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor vlerëson aftësinë e operatorit ekonomik për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë. Kërkesa konsiderohet proporcionale, pasi përmbushja e xhiros minimale kërkohet vetëm në të paktën një vit të periudhës së përcaktuar, çka e bën kriterin të ekuilibruar dhe jo tej mase kufizues për konkurrencën, duke ruajtur njëkohësisht garancinë për qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006

“Për sistemin e taksave vendore”, *i ndryshuar*), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, në nenin 43, pika 6, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, në Ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” *(i ndryshuar)*, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)* dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *(i ndryshuar)* në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se

20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *(i ndryshuar)*. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori i autorizuar, ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallin objekt prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)* dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohej në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohej që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë alternative (do të konsiderohen të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës pasi garantimi i cilësisë dhe origjinalitetit të produkteve të kërkuara është i rëndësishëm.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjetit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në Shtojcën 6.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)* dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *(i ndryshuar)*. Vendosja e këtij kriteri, referuar

edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me mallra të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti i ofruar është i prodhuar në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë të zbatueshme për vendosjen në treg dhe përdorim në tregun e Bashkimit Europian ose është i destinuar për përdorim në vendet e Bashkimit Europian. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë Deklaratë/Certifikatë Konformiteti EC/EU për mjetin e ofertuar, të lëshuar nga prodhuesi. Deklarata/Certifikata duhet të përmbajë të dhënat identifikuese dhe teknike të mjetit të ofertuar, si prodhuesin, markën, modelin, tipin/versionin, fuqinë dhe të dhëna të tjera përkatëse të identifikimit teknik, si dhe direktivat dhe standardet EC/EU të zbatueshme, sipas të cilave deklarohet konformiteti i mjetit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie për mjetin e ofruar jo më pak se 2 (dy) vite ose 2 000 (dy mijë) orë pune, cilado të plotësohet më parë, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë qartë kushtet dhe mbulimin e garancisë, përfshirë rastet që mbulohen nga garancia, përjashtimet, procedurën e njoftimit dhe mënyrën e trajtimit të defekteve gjatë periudhës së garancisë. Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të paraqesë, së bashku me ofertën, listën e shërbimeve të mirëmbajtjes profilaktike të parashikuara nga prodhuesi gjatë gjithë periudhës së garancisë, sipas intervaleve përkatëse të orëve të punës, si dhe çmimin për secilin shërbim profilaktik, duke përfshirë koston e punës, filtrave, vajrave, materialeve konsumatore dhe çdo elementi tjetër të nevojshëm për realizimin e këtyre shërbimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të treguar dhe regjistruar në pronësi të Autoritetit Kontraktor përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklaratat e ofertuesit sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në pikat **2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6** të Kriterëve të Veçanta janë të rëndësishme, pasi përveç se tregojnë aftësinë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i aftë për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

LOTI 2: “BLERJE MOTOÇIKLETA”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë afatit të vlefshmërisë së saj, si dhe për të mbrojtur autoritetin kontraktor nga tërheqja e pajustificuar e ofertës, mosparaqitja e dokumentacionit provues ose refuzimi i nënshkrimit të kontratës nga ofertuesi fitues. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit kërkohet si mjet paraprak për verifikimin e përmbushjes së kushteve të kualifikimit, në funksion të zhvillimit të një procedure efikase, të shpejtë dhe të kontrollueshme. Këto kërkesa vlerësohen të nevojshme për garantimin e rregullshmërisë së procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi”, të destinuara për përdorim në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës.

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1.1 Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, të cilin duhet ta deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij në fushën objekt prokurimi.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*. Paraqitja e pasqyrave financiare vjetore për 3 vitet e fundit kërkohet për t’i mundësuar autoritetit kontraktor verifikimin e gjendjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit ekonomik, në funksion të aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohet të vlerësohet nëse operatori ekonomik ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me mallrat objekt prokurimi. Kushti që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të verifikuar një nivel minimal qëndrueshmërie financiare dhe për të shmangur rrezikun e mosrealizimit të kontratës për shkaqe që lidhen me paaftësinë ekonomike të operatorit. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)* dhe në nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*. Paraqitja e pasqyrave financiare vjetore për 3 vitet e fundit kërkohet për t’i mundësuar autoritetit kontraktor verifikimin e gjendjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit ekonomik, në funksion të aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohet të vlerësohet nëse operatori ekonomik ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me mallrat objekt prokurimi. Kushti që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të verifikuar një nivel minimal qëndrueshmërie financiare dhe për të shmangur rrezikun e mosrealizimit të kontratës për shkaqe që lidhen me paaftësinë ekonomike të operatorit. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, në nenin 43, pika 6, të

VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*i ndryshuar*), në Ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” (*i ndryshuar*), neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (*i ndryshuar*). Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (*i ndryshuar*). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*) në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*). Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë*

duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në Shtojcën 6.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*). Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me mallra të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të Autoritetit Kontraktor përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku ofron garanci për motorrçikletat, jo më pak se 12 (*dymbëdhjetë*) muaj nga marrja në dorëzim e mjetit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklaratat e ofertuesit sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në pikat **2.3.4** dhe **2.3.5** të Kriterëve të Veçanta janë të rëndësishme, pasi përveç se tregon aftësinë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit që kërkohej në procedurë, garanton se ofertuesi është i aftë për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e dorëzimit të ofertave në orën dhe vendin e caktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor, nga jo më pak se një 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën Nr.7.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat duhet të paraqiten vetëm për artikujt e sipërcituar, objekt të këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*). Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga rëndësia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre. Në këtë rast paraqitja e mostrave është konsideruar nga autoriteti kontraktor si e nevojshme pasi verifikimi fizik i tyre është gjykuar i rëndësishëm për të vlerësuar plotësimin e standarteve teknike, sigurinë gjatë furnizimit së mallrave dhe sigurinë ndaj përdoruesve të tyre.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (*i ndryshuar*), si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*i ndryshuar*).

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.